



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME LUSHNJE SH.A

Nr. _____ Prot

Lushnje më, _____ / _____ / 2026

Shtojca 13.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË
ANKIMIT**

[Data] 20/07/2026

Drejtuar: ARKONSTUDIO me NIPT L42019004I 62.59% me adresë: Rruga Mihal Duri, Objekti Nr. 33 , Tirane, Tirana & ED KONSTRUKSION me NIPT K61625001I 37.41% me adresë: Kryqëzimi i Rrugës "Liman Kaba" me "Prokop Mima", Rezidenca "Olimpik" , Shkalla nr. 2, Kati 4, Tiranë

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☒ ARKONSTUDIO me NIPT L42019004I 62.59% me adresë: Rruga Mihal Duri, Objekti Nr. 33 , Tirane, Tirana & ED KONSTRUKSION 37% me NIPT K61625001I me adresë: Kryqëzimi i Rrugës "Liman Kaba" me "Prokop Mima", Rezidenca "Olimpik" , Shkalla nr. 2, Kati 4, Tiranë ☐ ose

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Punë

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur, me mjete elektronike

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: : **REF-86285-05-20-2026**

Rrjeti i Ujësjellësit të fshatrave Zhamë, Gramsh, Konjat, Dushk, Thanasaj Njesia administrative Dushk, Bashkia Lushnje

Data e Publikimit në SPE, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: 13.07.2026

¹Data e Publikimit në Buletin e Njoftimeve Publike, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit *Buletini Nr. 46 datë 20 Korrik 2026*

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

-oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto X

-oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim ☐

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

1. NDREGJONI	BOE	K31329048I	60%
UDHA		K77524909Q	10%
NIKA		J76705047U	30%

Vlera 318,436,664 (treqind e tetëmbëdhjetë milion e katërqind e tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. LLAZO	BOE	K24218401K	80%
VIBTIS		L02103503S	20%

Vlera 377,768,795 (treqind e shtatëdhjetë e shtatë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH;

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

¹ Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP

3. LIQENI VII**BOE****K01730502Ë 81.9****SARDO****K13120402W 14%****IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION (I.P.C)”****L91310511L 4.1%**

Vlera 400,452,024.7 (katërqind milion e katërqind e pesëdhjetë e dy mijë e njëzet e katër pikë shtatë) lekë pa TVSH;

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. AGI KONS**BOE****K21622001M 95%****C O L O M B O****J82916489E 5%**

Vlera 418,681,875.9 (katërqind e tëtmëdhjetë million e gjashtëqind e tetëdhjetë e një mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë pikë nëntë) lekë pa TVSH;

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5. BE-IS**K71412003A**

Vlera 460,860,555 (katërqind e gjashtëdhjetë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH;

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

6. SHENDELLI**K07924803N**

Vlera 461,969,981 (katërqind e gjashtëdhjetë e një milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një) lekë pa TVSH;

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

7. ALBA KONSTRUKSION**J61812013R**

Vlera 474,656,344.93 (katërqind e shtatëdhjetë e katër milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e dyzet e katër pikë nëntëdhjetë e tre) lekë pa TVSH;OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

8. SENKA

J94808405Q

Vlera 0 (zero)Lekë

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

9. ARKONSTUDIO

BOE

L42019004I 62.59 %

ED KONSTRUKSION

K61625001I 37.41%

Vlera 449,101,061.19 (katërqind e dyzet e nëntë milion e njëqind e një mijë e gjashtëdhjetë e një pikë nëntëmbëdhjetë) lekë pa TVSH;

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Etj. _____

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. NDREGJONI

BOE

K31329048I 60%

UDHA

K77524909Q 10%

NIKA

J76705047U 30%

Vlera 318,436,664 (treqind e tetëmbëdhjetë milion e katërqind e tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Arsyet:

Bashkimi i Operatorëve **NDREGJONI NIPT K31329048I & UDHA me NIPT K77524909Q & NIKA NIPT J76705047U** nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Pika 2.3.1:

2.3.1. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtem:

Ne rast se punimet janë kryer me ente publike:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, duhet të paraqesë Kontratën e Sipërmarrjes; formular vlerësimi leshuar nga Investitori sipas Shtojces 9; situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve; Faturat Tatimore të deklaruara në organet tatimore; Aktin e Kolaudimi; dhe Certifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përhershëm .

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

Ne rast se punimet janë kryer me sektorin privat:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vertetime të shoqeruara me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar).

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e

bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.

- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Nga dokumentacini i dorëzuar ne rrugë elektronike, rezulton se BOE ka paraqitur kontrata të ngjashme si më poshtë:

Operatori Ekonomik Ndrejoni dhe Operatori Ekonomik Nika kanë paraqitur vetëm një kontratë të ngjashme të realizuar gjatë pesë viteve të fundit të realizuar si Bashkim Operatorësh Ekonomikë ndërmjet tyre, e cila rezulton të jetë realizuar nga Operatori Ekonomik Ndrejoni shpk në masën 62.42% dhe Operatori Ekonomik Nika shpk 37.58% .

Vlera Totale e realizuar sipas situacionit përfundimtar është = 313, 911,614.2 lekë pa TVSH

Ndrejoni: $313,911,614.2 \times 62.42\% = 195,943,629.58$ lekë pa TVSH

Nika: $313,911,614.2 \times 37.58\% = 117,976,984.62$ lekë pa TVSH

Operatori Ekonomik Udha ka paraqitur dy kontrata të ngjashme të realizuara gjatë pesë viteve të fundit të realizuar si Bashkim Operatorësh Ekonomikë, nga ku rezulton se në një të kontratës ka realizuar 23.13% të punimeve, ku vlera e punimeve sipas situacionit përfundimtar është 231,973,258 lekë pa TVSH, ndërsa kontrata tjetër e paraqitur është realizuar 100% nga Operatori Ekonomik Udha, në vlerën sipas situacionit përfundimtar 74,083,800 lekë pa TVSH.

Përsa i takon kontratës së parë: $231,973,258 \times 23.13\% = 53,678,611.9$ lekë pa TVSH.

Në Total Udha Shpk ka paraqitur kontrata të ngjashme në vlerën: $53,678,611.9 + 74,083,800 = 127,762,411.9$ lekë pa TVSH.

Përsa më sipër, referuar kontratave të paraqitura nga ky Bashkim Operatorësh Ekonomik, rezulton se:

Operatori ekonomik Ndrejoni Shpk nuk plotëson asnjërin nga kushtet e kriterit për kualifikim, pasi sipas Marrëveshjes së Bakëpunimit të paraqitur për procedurën objekt prokurimi Operatori Ekonomik ka marrë përsipër të kryjë 60% të punimeve.

Për të plotësuar germën a) *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës*, pika e cila duhet plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim, operatori ekonomik duhet të kishte dorëzuar një kontratë të ngjashme të realizuar në vlerën: $474,443,062.3$ (Fondi Limit) $\times 50\% = \underline{239,721,531}$ lekë pa TVSH.

Për të plotësuar germën b) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH)*, e cila plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” te ndryshuar), operatori Ekonomik duhet të kishte dorëzuar kontrata të ngjashme të realizuar në vlerën: $474,443,062.3$ (Fondi Limit) $\times 200\% \times 60\%$ (Pjesëmarrja sipas Marrëveshjes se BOE) = $\underline{575,331,675}$ lekë pa TVSH.

Operatori Ekonomik Ndregjoni ka paraqitur një kontratë të ngjashme e cila është në vlerën 195,943,629.58 lekë pa TVSH, dhe si e tillë nuk plotëson kriterin për kualifikim.

Operatori ekonomik Nika Shpk nuk plotëson kriterin për kualifikim, pasi sipas Marrëveshjes së Bakëpunimit të paraqitur për procedurën objekt prokurimi Operatori Ekonomik ka marrë përsipër të kryjë 30% të punimeve.

Për të plotësuar germën b punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH), e cila plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar), operatori Ekonomik duhet të kishte dorëzuar kontrata të ngjashme të realizuar në vlerën: 474,443,062.3 (Fondi Limit) x 200% x 30% (Pjesëmarrja sipas Marrëveshjes së BOE) = 278,665,837.5 lekë pa TVSH.

Operatori Ekonomik Nika ka paraqitur dy kontrata të ngjashme e cila është në vlerën 117,976,984.62 lekë pa TVSH, dhe si e tillë nuk plotëson kriterin për kualifikim.

Operatori ekonomik Udha Shpk plotëson kriterin për kualifikim, pasi sipas Marrëveshjes së Bakëpunimit të paraqitur për procedurën objekt prokurimi Operatori Ekonomik ka marrë përsipër të kryjë 10% të punimeve.

Për të plotësuar germën b punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH), e cila plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar), operatori Ekonomik duhet të kishte dorëzuar kontrata të ngjashme të realizuar në vlerën: 474,443,062.3 (Fondi Limit) x 200% x 10% (Pjesëmarrja sipas Marrëveshjes së BOE) = 95,888,612.5 lekë pa TVSH.

Operatori Ekonomik Udha ka paraqitur dy kontrata të ngjashme të cilat janë në vlerën 127,762,411.9 lekë pa TVSH, dhe si e tillë plotëson kriterin për kualifikim.

Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Në nenin 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se:

“5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sqarojmë, se referuar rregullave të prokurimit publik, për kontratat për punë publike, për të provuar përvojën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë njërin prej dy kushteve të përcaktuara në nenin 39, pika 5 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku operatori ekonomik duhet të provojë, se ka kryer punë të ngjashme për një objekt të vetëm, në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose të provojë se ka kryer punë të

ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për punë publike, ligjvënësi në nenin 39, pika 5 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, të ndryshuar, ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga enti publik, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë ose me sektorin privat me paraqitjen e vërtetimeve të shoqëruar dhe me fatura tatimore ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, *ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në shqyrtim të ofertës së paraqitur nga ky BOE është referuar më tej vendimeve të ngjashme të Komisionit të Prokurimit Publik me Nr.755/2024 datë 1.7.2024 dhe Vendimin Nr.611/2020.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi.

KVO vlerëson se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për shkak të ekonomicitetit procedural ka vlerësuar të panevojshëm vijimin e verifikimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik, duke qënë se përsëri statusi juridik i këtij operatori do të mbetet i skualifikuar.

Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s’kualifikimin e

Bashkimit të Operatorëve Ekonomik **Shoqëria "NDREGJONI"** shpk me NIPT K31329048I & Shoqëria **"UDHA"** shpk me NIPT K77524909Q & Shoqëria **"NIKA"** shpk me NIPT J76705047U.

2. LLAZO	BOE	K24218401K 80%
VIBTIS		L02103503S 20%

Vlera 377,768,795 (treqind e shtatëdhjetë e shtatë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH;
OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Arsyet:

Bashkimi i Operatorëve Ekonomik **Shoqëria "LLAZO"** shpk me NIPT K24218401K & Shoqëria **"VIBTIS"** shpk me NIPT L02103503S nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Pika 2.3.1:

1.3.1. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojes së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtem:

Ne rast se punimet janë kryer me ente publike:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, duhet të paraqesë Kontratën e Sipërmarrjes; formular vlerësimi leshuar nga Investitori sipas Shtojces 9; situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve; Faturat Tatimore të deklaruara në organet tatimore; Aktin e Kolaudimi; dhe Certifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përhershëm. Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

Ne rast se punimet janë kryer me sektorin privat:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vertetime të shoqeruara me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Pika 2.3.1 gërma "a" plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” te ndryshuar).

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Nga dokumentacini i dorëzuar ne rrugë elektronike, rezulton se BOE ka paraqitur kontrata të ngjashme si më poshtë:

Operatori Ekonomik Llazo shpk ka paraqitur një kontratë të ngjashme të realizuar gjatëq pesë viteve të fundit në cilësinë e nënkontraktorit, kontratë e cila rezulton të jetë në vlerën 696,343,315.52 lekë pa TVSH, ku Llazo ka kryer 38% të punimeve, vlerë e është $696,343,315.52 \times 38\% = 264,610,459.89$ lekë pa tvsh.

Për të plotësuar germën a) *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, pika e cila duhet plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim*, operatori ekonomik duhet të dorëzojë një kontratë të ngjashme të realizuar në vlerën: $474,443,062.3$ (Fondi Limit) $\times 50\% = 239,721,531$ lekë pa TVSH.

Për rrjedhojë OE Llazo ka paraqitur një kontratë të ngjashme e cila e tejkalon 50% e fondit limit dhe e plotëson kriterin për kualifikim.

Operatori Ekonomik VIBTIS shpk ka paraqitur tre kontrata të realizuara më parë, të cilat konsistojnë si më poshtë:

- ndërtim godine në vlerën e realizuar 100 % nga ana e tij, vlerë e barabartë me 77,864,054.75 lekë pa TVSH;
- punime civile dhe elektromekanike në hidrovore, në vlerë të realizuar 100 % nga ana e tij, vlerë e barabartë me 18,245,835.5 lekë pa TVSH;
- kontratë për furnizimin e mallrave dhe transportin e tyre, kontratë e cila nuk përmbush asnjërin prej komponentëve që përbëjnë përvojën e ngjashme.

Në total Operatori Vibtis shpk ka paraqitur si përvojë për punë të ngjashme, kontrata të barabarta me vlerën: $77,864,054.75 + 18,245,835.5 = 96,109,890.25$ lekë pa TVSH.

Përsa më sipër, referuar kontratave të paraqitura nga Operatori Ekonomik Vibtis shpk, pjesëmarrjes prej 20% të kryerjes së punimeve sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit, rezulton se:

Për të plotësuar germën b) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH), e cila plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” te ndryshuar)*, operatori

Ekonomik duhet të kishte dorëzuar kontrata të ngjashme të realizuar në vlerën: 474,443,062.3 (Fondi Limit) x 200% x 20% (Pjesëmarrja sipas Marrëveshjes se BOE) = 191,777,225 lekë pa TVSH.

Për të plotësuar germën a) *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, pika e cila duhet plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim*, operatori ekonomik duhet të dorëzojë një kontratë të ngjashme të realizuar në vlerën: 474,443,062.3 (Fondi Limit) x 50% = 239,721,531 lekë pa TVSH.

Operatori Ekonomik Vibits shpk ka paraqitur dy kontrata të ngjashme të cilat së bashku janë në vlerën 96,109,890.25 lekë pa TVSH, dhe si e tillë nuk plotëson kriterin për kualifikim.

Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

d) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

e) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*

f) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Në nenin 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se:

“5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

c) *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*

d) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sqarojmë, se referuar rregullave të prokurimit publik, për kontratat për punë publike, për të provuar përvojën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë njërin prej dy kushteve të përcaktuara në nenin 39, pika 5 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, e ndryshuar, ku operatori ekonomik duhet të provojë, se ka kryer punë të ngjashme për një objekt të vetëm, në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose të provojë se ka kryer punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për punë publike, ligjvënësi në nenin 39, pika 5 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, të ndryshuar, ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga enti publik, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë ose me sektorin privat me paraqitjen e vërtetimeve të shoqëruar dhe me fatura tatimore ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, *ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në shqyrtim të ofertës së paraqitur nga ky BOE është referuar më tej vendimeve të ngjashme të Komisionit të Prokurimit Publik me Nr.755/2024 datë 1.7.2024 dhe Vendimin Nr.611/2020.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për shkak të ekonomicitetit procedural ka vlerësuar të panevojshëm vijimin e verifikimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik, duke qënë se përsëri statusi juridik i këtij operatori do të mbetet i skualifikuar.

Sa më lart, referuar nenit 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s’kualifikimin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik Shoqëria “LLAZO” shpk me NIPT K24218401K& Shoqëria “VIBTIS” shpk me NIPT L02103503S.

3.LIQENI VII

BOE

K01730502Ë 81.9

SARDO

K13120402W 14%

IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION (I.P.C)”

L91310511L 4.1%

Vlera 400,452,024.7 (katërqind milion e katërqind e pesëdhjetë e dy mijë e njëzet e katër pikë shtatë) lek pa TVSH;

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

* * *

Arsyet:

Bashkimi i Operatorëve Ekonomik Shoqëria “LIQENI VII” shpk me NIPT JK01730502W & Shoqëria ”SARDO” shpk me NIPT K13120402W & Shoqëria “IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION (I.P.C)” shpk me NIPT L91310511L nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Pika 2.3.1:

2.3.1. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtem:

Ne rast se punimet janë kryer me ente publike:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, duhet të paraqesë Kontratën e Sipërmarrjes; formular vlerësimi lëshuar nga Investitori sipas Shtojces 9;situcion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve;Faturat Tatimore të deklaruara në organet tatimore; Aktin e Kolaudimi; dhe Certifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përhershëm .

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

Ne rast se punimet janë kryer me sektorin privat:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vertetime të shoqeruara me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar).

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Nga dokumentacini i dorëzuar ne rrugë elektronike, rezuton se BOE ka paraqitur kontrata të ngjashme si më poshtë:

Operatori Ekonomik LIQENI VII ka paraqitur vetëm një kontratë të ngjashme të realizuar gjatë pesë viteve të fundit të realizuar në masën 100% të punimeve nga ana e tij.

Vlera Totale e realizuar sipas situacionit perfundimtar është = 256,572,218 lekë pa TVSH, dhe për rrjedhojë OE LIQENI VII e plotëson kriterin për kualifikim.

Operatori Ekonomik SARDO shpk ka paraqitur një kontratë të ngjashme të realizuara gjatë pesë viteve të fundit të realizuar si Bashkim Operatorësh Ekonomikë, nga ku rezulton se ka realizuar 50% të punimeve, ku vlera e punimeve sipas situacionit përfundimtar është 76,470, 966 lekë pa TVSH, ku OE SARDO ka realizuar $76,470,966 \times 50\% = 38,235,483$ lekë pa TVSH

Operatori Ekonomik IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION shpk ka paraqitur një kontratë të ngjashme të realizuara gjatë pesë viteve të fundit të realizuar si Bashkim Operatorësh Ekonomikë, nga ku rezulton se ka realizuar 100% të punimeve, ku vlera e punimeve sipas situacionit përfundimtar është 17,500,000 lekë pa TVSH.

Përsa më sipër, referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit të paraqitur nga BOE për objektin e prokurimit, rezulton se OE LIQENI VII ka marrë përsipër të kryejë 81.90% të punimeve, OE SARDO ka marrë përsipër të kryejë 14% të punimeve, ndërsa OE IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION ka marrë përsipër të kryejë 4.1% të punimeve.

Operatori ekonomik Liqeni VII, si anëtar që ka marrë përsipër përqindjen më të lartë të kryerjes së punimeve duhet të plotësojë germën a të kriterit për kualifikim:

Për të plotësuar germën a) *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, pika e cila duhet plotësohet nga anëtar i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim*, operatori ekonomik duhet të dorëzojë një kontratë të ngjashme të realizuar në vlerën: $474,443,062.3 \text{ (Fondi Limit)} \times 50\% = 239,721,531 \text{ lekë pa TVSH}$, nga ku rezulton se ky operator ekonomik e përmbush kriterin për kualifikim.

Operatori ekonomik SARDO, si anëtar që ka 14% të kryerjes së punimeve duhet të plotësojë germën b të kriterit për kualifikim:

Për të plotësuar germën b *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH), e cila plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” te ndryshuar)*, operatori Ekonomik duhet të kishte dorëzuar kontrata të ngjashme të realizuar në vlerën: $474,443,062.5 \text{ (Fondi Limit)} \times 200\% \times 14\% \text{ (Pjesëmarrja sipas Marrëveshjes se BOE)} = 132,944,057.5 \text{ lekë pa TVSH}$, nga ku rezulton se ky operator referuar përvojës së mëparshme të realizuar, të dorëzuar prej tij, nuk e përmbush kriterin për kualifikim.

Operatori ekonomik IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION, si anëtar që ka 4.1% të kryerjes së punimeve duhet të plotësojë germën b të kriterit për kualifikim:

Për të plotësuar germën b *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH), e cila plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” te ndryshuar)*, operatori Ekonomik duhet të kishte dorëzuar kontrata të ngjashme të realizuar në vlerën: $474,443,062.5 \text{ (Fondi Limit)} \times 200\% \times 4.1\% \text{ (Pjesëmarrja sipas Marrëveshjes se BOE)} = 38,904,331.1 \text{ lekë pa TVSH}$, nga ku rezulton se ky operator referuar përvojës së mëparshme të realizuar, të dorëzuar prej tij, nuk e përmbush kriterin për kualifikim.

Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:
1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

g) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

h) gjendjen ekonomike dhe financiare;

i) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Në nenin 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se:

“5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

e) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

f) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative,

makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sqarojmë, se referuar rregullave të prokurimit publik, për kontratat për punë publike, për të provuar përvojën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë njërin prej dy kushteve të përcaktuara në nenin 39, pika 5 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, e ndryshuar, ku operatori ekonomik duhet të provojë, se ka kryer punë të ngjashme për një objekt të vetëm, në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose të provojë se ka kryer punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për punë publike, ligjvënësi në nenin 39, pika 5 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, të ndryshuar, ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga enti publik, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë ose me sektorin privat me paraqitjen e vërtetimeve të shoqëruar dhe me fatura tatimore ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, *ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në shqyrtim të ofertës së paraqitur nga ky BOE është referuar më tej vendimeve të ngjashme të Komisionit të Prokurimit Publik me Nr.755/2024 datë 1.7.2024 dhe Vendimin Nr.611/2020.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për shkak të ekonomicitetit procedural ka vlerësuar të panevojshëm vijimin e verifikimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik, duke qënë se përsëri statusi juridik i këtij operatori do të mbetet i skualifikuar.

Sa më lart, referuar nenit 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024, ku parashikohet: *“Autoriteti ose enti kontraktor në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”*, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor **bëri s`kualifikimin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik Shoqëria “LIQENI VII” shpk me NIPT JK01730502W & Shoqëria “SARDO” shpk me NIPT K13120402W & Shoqëria “IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION (I.P.C)” shpk me NIPT L91310511L.**

4. AGI KONS
C O L O M B O

BOE

K21622001M 95%
J82916489E 5%

Vlera 418,681,875.9 (katërqind e tëtmbëdhjetë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e një mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë pikë nëntë) lek pa TVSH;

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Arsyet:

Bashkimi i Operatorëve **Shoqëria “AGI KONS” shpk** me **NIPT K21622001M& Shoqëria “C O L O M B O” shpk** me **NIPT J82916489E** nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Pika 2.3.2:

c) Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:

- ✓ **Tuba Ujësjellësi PE 100 RC SDR11**
- ✓ **Rakorderi Elektrofuzive**
- ✓ **Mates uji elektromagnetik**
- ✓ **Elektropompa centrifugale**
- ✓ **Pompe Zhytëse Q=40 35 l/s H=60 m**
- ✓ **Sistem Scada**

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesitose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.
- Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përket.
- Operatori Ekonomik për të gjitha materialet e mësipërme duhet të paraqesë **çertifikatë / vetëdeklarim nga Prodhuesi** që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit/ve është sipas standartit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Shënim: Të gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtori.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur për artikullin “Rakorderi elektrofuzive”, rezulton se nuk dëshmohet lidhja midis ofertues-distributor-prodhues.Prodhuesi është ALIAXIS Hungary, i cili autorizon HIDRO MENTORI si Distributor, por nuk është paraqitur asnjë dokument që vërteton që Hidro Mentori në cilësinë e Distributorit ka autorizuar BOE për të ofruar mallrat sipas listës së artikujve të kërkuar në kuadër të kriterëve të veçanta për kualifikim.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur për artikullin “Mates uji elektromagnetik”, rezulton se nuk dëshmohet lidhja midis ofertues-distributor-prodhues.Prodhuesi është B METERS, i cili autorizon HIDRO MENTORI si Distributor, por nuk është paraqitur asnjë dokument që vërteton që Hidro Mentori në cilësinë e Distributorit ka autorizuar BOE për të ofruar mallrat sipas listës së artikujve të kërkuar në kuadër të kriterëve të veçanta për kualifikim.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi.

KVO vlerëson se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit *dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në shqyrtim të ofertës së paraqitur nga ky BOE është referuar më tej vendimeve të ngjashme të Komisionit të Prokurimit Publik me Nr.115/2021, etj.

Bashkimi i Operatorëve **Shoqëria “AGI KONS” shpk** me NIPT K21622001M& Shoqëria **“C O L O M B O” shpk** me NIPT J82916489E nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.3.3

c) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin tjetër inxhinierik** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Elektrik /Mekatronik 1 (një)

Për stafin e mësipërm inxhinierik Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

❖ **Stafi i kërkuar në pikën 2.3.3 pika c, nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.**

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në rrugë elektronike, Formulari Përmbledhës i deklarimit, rezulton se asnjëri nga anëtarët e bashkimit të operatorëve nuk ka vetëdeklaruar angazhimin e stafit të propozuar si pjesë e stafit jo domosdoshmërit në licencën e shoqërisë, ashtu sikurse është kërkuar nga AK në kriteret e veçanta për kualifikim.

Secili prej tyre ka deklaruar vetëm angazhimin e Drejtuesve Teknik të objektit si më poshtë:

D. Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jene ne dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut te punimeve.

Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar:

Z. Lejdi Ahmeti me profesion Inxhinier Ndërtimi, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Drejtues Teknik/Inxhinier ndërtimi,



i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Emri, Mbiemri Alban Çinari

Firma

Vula

Data e dorëzimit të deklaratës 12.06.2026



Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jene ne dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut te punimeve.

Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar:

Z. Arqile Shishko me profesion Ing.Ndërtimi, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Ing.Ndërtimi, etj .,

i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Shoqeria "C O L O M B O" shpk

Adm.Diana LABA



Data 12.06.2026

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Dokumentacioni i paraqitur nga ana e operatorit ekonomik në këtë procedurë prokurimi, objekt vlerësimi nuk është i rregullt dhe për shkak të mangësive që ka nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i pavlefshëm.

Komisioni i Vlerësimit sqaron se, mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për shkak të ekonomicitetit procedural ka vlerësuar të panevojshëm vijimin e verifikimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik, duke qënë se përsëri statusi juridik i këtij operatori do të mbetet i skualifikuar.

Sa më lart, referuar nenit 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024, ku parashikohet: “*Autoriteti ose enti kontraktor në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji*”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor **bëri s`kualifikimin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik Shoqëria “AGI KONS” shpk me NIPT K21622001M& Shoqëria “C O L O M B O” shpk me NIPT J82916489E.**

5. BE-IS

K71412003A

Vlera 460,860,555 (katërqind e gjashtëdhjetë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH;

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Arsyet:

Operatori Ekonomik **Shoqëria “BE-IS” shpk** me **NIPT K71412003A**, nuk plotëson Kriteret e Vecanta për kualifikim, pika 2

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Nga dokumentacioni i dorëzuar në rrugë elektronike rezulton se Operatori Ekonomik **Shoqëria “BE-IS” shpk** nuk ka paraqitur Sigurimin e ofertës sipas Shtojcës 3.

Në nenin 83, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: Neni 83 Sigurimi i ofertës

1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllëgoaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës: i. në formën e garancisë bankare; ose ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.

3. Autoriteti ose enti kontraktor konfiskon sigurimin e ofertës në rast të: a) tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave; b) refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit. c) mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimi të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

4. Autoriteti ose enti kontraktor nuk e pretendon vlerën e sigurimit të ofertës dhe kthen menjëherë mbrapsht dokumentin e sigurimit të ofertës, nëse: a) ka përfunduar afati kohor i sigurimit të ofertës; b) është lidhur kontrata dhe është paraqitur sigurimi i kontratës, kur një gjë e tillë kërkohet nga dokumentet e tenderit; c) janë anuluar procedurat e tenderit pa shpallur fitues.

5. Autoriteti ose enti kontraktor raporton pranë Agjencisë së Prokurimit Publik rastet e tërheqjes së operatorit ekonomik sipas parashikimeve të këtij neni.

6. Kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk nënshkruan kontratën, autoriteti kontraktor bën konfiskimin e sigurimit të ofertës. Në rastin kur është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim” dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe të dytë është jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës të ofertuesit që është tërhequr.

Komisioni vlerëson se Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Përsa më sipër nga verifikimi rezultron se ky operator ekonomik nuk ka paraqitur Shtojcën Nr.3, duke mos plotësuar kështu dokumentacionin e kërkuar nga ky operator sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentat standarte të tenderit. Ndodhur në kto kushte operatori ekonomik është në mospoltësim të kritereve të vendosura nga autoriteti kontraktor.

Operatori Ekonomik **Shoqëria “BE-IS” shpk** me NIPT K71412003A, nuk plotëson Kriteret e Vecanta për kualifikim, pika 2.3.1

2.3.1. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- c. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- d. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtem:

Ne rast se punimet janë kryer me ente publike:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, duhet të paraqesë Kontratën e Sipërmarrjes; formular vlerësimi lëshuar nga Investitori sipas Shtojcës 9; situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve; Faturat Tatimore të deklaruara në organet tatimore; Aktin e Kolaudimi; dhe Certifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përhershëm .

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

Ne rast se punimet janë kryer me sektorin privat:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vertetime të shoqëruara me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar).

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Nga dokumentacionin i dorëzuar në rrugë elektronike, rezulton se OE ka paraqitur kontrata të ngjashme si më poshtë:

- *Sistemi i Furnizimit me Ujë, Hamallaj Faza I*, e cila nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton të këtë përfunduar në datë 03.04.2020 dhe kolauduar në datë 30.04.2020, gjë që bie ndesh me kriterin për kualifikim gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- *Ndërtimi i rrjetit të jashtëm të ujësjellësit Këlcyrë*, e cila nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton të këtë përfunduar në datë 15.10.2020 dhe kolauduar në datë 29.10.2020, gjë që bie ndesh me kriterin për kualifikim gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- *Furnizimi me ujë nga pusshpimet e Dropullit*, nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se është brënda afatit gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
Kontrata është realizuar si BOE , ku BE-IS ka realizuar 50.099% të punimeve, ku vlera sipas situacionit përfundimtar është 79,129,675 lekë pa TVSH, nga ku BE-IS ka realizuar $79,129,675 \times 50.099\% = 39,571,959.17$ lekë pa TVSh.
- *Ndërtimi i Ujësjellësit Dropull*, nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se është brënda afatit gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
Kontrata është realizuar si BOE , ku BE-IS ka realizuar 70.05% të punimeve, ku vlera sipas situacionit përfundimtar është 328,139,297 lekë pa TVSH, nga ku BE-IS ka realizuar $328,139,297 \times 70.05\% = 229,861,557.55$ lekë pa TVSh.
- *Ndërtimi i Ujësjellësit për Njësisë Adm. Ballaban, Suke...*, nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se është brënda afatit gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
Kontrata është realizuar si BOE , ku BE-IS ka realizuar 80% të punimeve, ku vlera sipas situacionit përfundimtar është 233,606,230 lekë pa TVSH, nga ku BE-IS ka realizuar $233,606,230 \times 80\% = 186,884,984$ lekë pa TVSh.
- *Ndërtimi i rrjetit të Ujësjellësit në zonën e Autostradës...*, nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se është brënda afatit gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
Kontrata është realizuar si BOE , ku BE-IS ka realizuar 52% të punimeve, ku vlera sipas situacionit përfundimtar është 186,425,950 lekë pa TVSH, nga ku BE-IS ka realizuar $186,425,950 \times 52\% = 96,941,494$ lekë pa TVSh.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik nuk e plotëson kriterin për kualifikim pasi:

Për të plotësuar germën a) *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës*, pika e cila duhet plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim, operatori ekonomik duhet të kishte dorëzuar një kontratë të ngjashme të realizuar në vlerën: $474,443,062.3$ (Fondi Limit) $\times 50\% = 239,721,531$ lekë pa TVSH. Nga kontratat e paraqitura, asnjëra prej tyre nuk është sa 50% e fondit limit.

Për të plotësuar germën b) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH)*, e cila plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” te ndryshuar), operatori Ekonomik duhet të kishte dorëzuar kontrata të ngjashme të realizuar në vlerën: $474,443,062.3$ (Fondi Limit) $\times 200\% = 948,886,125$ lekë pa TVSH. Totali i vlerës së kontratave të paraqitura në tërësi është : $229,861,557.55 + 186,884,984 + 96,941,494 = 513,688,035.55$ lekë pa TVSH.

Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:
1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- j) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- k) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- l) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Në nenin 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se:

“5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- g) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- h) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sqarojmë, se referuar rregullave të prokurimit publik, për kontratat për punë publike, për të provuar përvojën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë njërin prej dy kushteve të përcaktuara në nenin 39, pika 5 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, e ndryshuar, ku operatori ekonomik duhet të provojë, se ka kryer punë të ngjashme për një objekt të vetëm, në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose të provojë se ka kryer punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për punë publike, ligjvënësi në nenin 39, pika 5 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, të ndryshuar, ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga enti publik, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë ose me sektorin privat me paraqitjen e vërtetimeve të shoqëruar dhe me fatura tatimore ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, *ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në shqyrtim të ofertës së paraqitur nga ky BOE është referuar më tej vendimeve të ngjashme të Komisionit të Prokurimit Publik me Nr.755/2024 datë 1.7.2024 dhe Vendimin Nr.611/2020.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për shkak të ekonomicitetit procedural ka vlerësuar të panevojshëm vijimin e verifikimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik, duke qënë se përsëri statusi juridik i këtij operatori do të mbetet i skualifikuar.

